



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1137/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Milena Đerić dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e OJQ Birn dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega ne Drenas për shkak të vendosjes së posterave afër Qendrës së Votimit, për Raundin e dytë, të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura me datë 14.11.2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 15.11.2021, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.1137/2021 e datës 14.11.2021, e paraqitur nga OJQ Birn dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, me të cilin ka kërkuar që Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës me seli në Prishtinë, dega në Drenas t'i shqiptohet gjobë për shkak të vendosjes së fletushkave në afërsi të Qendrës së Votimit, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 14.11.2021.

A r s y e t i m

PZAP-i me datën 14.11.2021, ka pranuar një ankesë A.nr.1137/21 nga OJQ Birn dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë e Kosovës, me të cilën pretendon se me datë 14 nëntor 2021, ne Komunën e Drenasit me saktësisht ne vendvotimin 0301E, ne shkollën “Rasim Kiqina” ne Drenas, ne ditën e zgjedhjeve me 14 nëntor ne oborrin e shkollës janë hasur fletushka me fotografi dhe numërin e kandidatit Ramiz Lladrovci te vendosura ne disa shtylla te ndriçimit elektrik përreth oborrit te shkollës, ky veprim bie ndesh me Planin Operacional për Organizimin e Zgjedhjeve Lokale, Ligjit për Zgjedhjet e përgjithshme ne Kosove dhe Rregullat e parapara te sjelljes për zgjedhje. Neni 3 pika 3.4 parasheh se materialet e shtypura te fushatës zgjedhore nuk duhet te vendosen brenda institucioneve publike si shkolla.

Po ashtu është e ndaluar shpërndarja ose shfaqja e çfarëdo materiali 100 metra brenda qendrave te votimit me qellim ndikimi tek votuesit neni 7.1 i Rregullës për nr. 11/2013

Paraqitësi i ankesës, si dëshmi për pretendimet e tij, ankesës i ka bashkangjitur një fotografi të printuar ne vendin ku është ngjitur poster si dhe videot ne afertesi te shkollës

PZAP-i, në kuptim të nenit 7 paragrafi 1, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e ka njoftuar subjektin politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) për ankesën që është bërë ndaj tyre dhe ka kërkuar që të përgjigjen deri më datë 15.11.2021, në ora 10:00. Në përgjigje

në ankesë të datës 15.11.2021, subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), konsideron se pretendimet e OJQ Birn the Internews janë jo të drejta dhe të pabazuara, për faktin se veprimi nuk është bërë nga Partia Demokratike e Kosovës dhe as nga simpatizantët apo anëtarët e saj. Kjo vërehet letë për faktin se nuk është e vendosur në formatin që të ndihmojë kandidatin tone. Ky material fletushke apo vizitkarta nuk është për tu vendosur në shtylla elektrike andaj është inskenim për të na dëmtuar neve .Po ashtu me datën 15 tetor 2021 kemi bërë thirrje në gjitha degëve që të zbatohet Ligji për Zgjedhje dhe të gjitha rregullativave ligjore.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Parashtruesi i ankesës me ankesën e tij pretendon se në afërsi të shkollës “Rasim Kiqina” në Drenas OJQ Birn dhe Internews kanë hasur në fletushka me fotografi dhe numrin e kandidatit Ramiz Lladrovci të vendosura në disa shtylla të ndriçimit elektronik rreth oborrit të shkollës Si dëshmi ka bashkangjitur një fotografi të printuar dhe videot në afërsi të shkollës.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara nga parashtruesi i ankesës nuk mund të konstatohet se kush i ka vendosur ato fletushka në afërsi të qendrës së votimit, si dhe të njëjtat a kanë qene të vendosura ditën e votimit apo me herët, sepse nga fotoja dhe videot e ofruar nuk mund të identifikohet në mënyrë bindëse dhe të qartë pretendimet e parashtruesit të ankesës.

Duke marrë parasysh të cekurat më lartë, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret të provuarit e asaj se kush i ka vendosur fletushkat dhe në cilën kohë janë vendosur.

Nga arsyet e theksuar më lartë, duke bazuar nënin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.1137/2021 më datën 15.11.2021

Kryesuesi i Panelit
Ferki Xhafëri



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.